

V E N D I M
Nr.527, datë 12.8.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.12, DATË
9.1.1993 “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE “PËR
LEHTËSIMIN E VARFËRISË SË ZONAVE RURALE””**

Në statutin e “Fondacionit për zhvillimin rural”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.12, datë 9.1.1993, bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi i fondacionit ndryshohet në “Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit”

2. Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Këshilli drejtues, i cili në vazhdim do të cilësohet “Këshilli”, do të përbëhet nga:

- Ministër, i caktuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

- Zëvendësministri i Financave.

- Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal.

- Drejtori i Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale.

- Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave.

- Drejtori i APO-s pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Anëtarët e këshillit nuk do të paguhen për shërbimet e tyre.

3. Në nenet 8, 12 dhe 20 fjalët “zëvendëskryeministri” zëvendësohet me fjalët “Ministri, i caktuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi